

UDHËZIM
Nr. 16, datë 19.10.2022

**PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR TË
PARANDALUAR HYRJEN DHE PËRHAPJEN BRENDA VENDIT TË XYLELLA
FASTIDIOSA (ËELLS ET AL)**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 204, datë 28.12.2023; nr. 22, datë 14.7.2025)

(i përditësuar)

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është të parandalojë hyrjen dhe përhapjen e dëmtuesit karantinor *Xylella fastidiosa* (Ëells et al.), brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizimet

(Shtuar shkronja “dh” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në nenin 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar dhe në nenin 2, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022 për miratimin e rregullores “Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, kanë të njëjtin kuptim.

Ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Dëmtues i specifikuar” është *Xylella fastidiosa* (Ëells et al.) dhe çdo nënspecie të saj;
- b) “Bimë bujtëse” është çdo bimë për mbjellje, përveç farave, që u përkasin gjinive ose specieve të listuara në aneksin I;
- c) “Bimë të specifikuar” është bima bujtëse për mbjellje, përveç farave, që u përkasin gjinive ose specieve të listuara në aneksin II dhe që dihet se janë të ndjeshme ndaj nënspecieve specifike të dëmtuesit të specifikuar;
- ç) “Monitorim” është një procedurë zyrtare në vazhdim për verifikimin e situatave fitosanitare;
- d) “Mbikëqyrje” është një procedurë zyrtare, i cili mbledh dhe regjistron të dhëna për praninë ose mungesën e dëmtuesve me anë të vrojtimit, monitorimit ose procedurave të tjera.
- dh) “Vektor” është insekti i rendit *Cicadomorpha* që dihet se transmeton dëmtuesin e specifikuar te bimët ose çdo insekt tjetër që dyshohet se transmeton dëmtuesin e specifikuar te bimët.

KREU II

**VROJTIMET VJETORE PËR PRANIN E DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR DHE PLANET
E KONTIGJENCËS**

Neni 3

Vrojtimet për dëmtuesin e specifikuar në territorin e vendit

(Ndryshuar pika 1 dhe 4, shtuar pika 4.1 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryen vrojtime vjetore të bimëve bujtëse, si dhe të çdo specie tjetër bimore në rast dyshimi për infeksion, për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar brenda territorit të vendit. Këto vrojtime mund të përfshijnë edhe vektorët.

2. Vrojtimet kryhen nga AKVMB-ja ose nën mbikëqyrjen zyrtare të AKVMB-së.

3. Vrojtimet kryhen bazuar në kontrollet me bazë risku. Vrojtimet do të kryhen në mjedise të hapura duke përfshirë fushat e mbjellura, pemëtoret, vreshtat, si dhe fidanishtet, qendrat e kopshteve dhe/ose qendrat tregtare, zonat natyrore dhe vendndodhjet e tjera përkatëse.

4. Këto vrojtime përfshijnë mbledhjen e mostrave dhe testimin e bimëve për mbjellje dhe, nëse është e zbatueshme, edhe të vektorëve. Duke marrë parasysh udhëzimet e Autoritetit Evropian për Sigurinë Ushqimore për vrojtime statistikisht të besueshme dhe të bazuara në risk për *Xylella fastidiosa*, modeli i vroitimit dhe skema e mostrimit që do të përdoret duhet të mundësojë zbulimin, me një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, të një niveli të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar në territorin e vendit.

4.1 Në rast se prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet te një vektor, në një zonë ku dëmtuesi i specifikuar nuk dihet të jetë i pranishëm, AKVMB-ja, pa vonesë, të kryejë vrojtime në një rreze prej të paktën 400 metrash përreth vendit ku është konstatuar vektori i infektuar, si dhe të marrë mostra dhe të kryejë teste të bimëve bujtëse dhe të çdo specie tjetër bimore në rast dyshimi për infeksion.

5. Këto studime do të kryhen në periudha të përshtatshme të vitit në lidhje me mundësinë e zbulimit të dëmtuesit të specifikuar, duke marrë parasysh biologjinë e dëmtuesit dhe vektorëve të tij, praninë dhe biologjinë e bimëve bujtëse, si dhe informacionin shkencor dhe teknik referuar në skedën e vroitimit të dëmtuesit mbi *Xylella fastidiosa*.

6. Prania e dëmtuesit të specifikuar do të analizohet me një nga testet molekulare të renditura në aneksin III të këtij udhëzimi. Në rast të rezultateve pozitive të zbuluara në zona të ndryshme nga zonat e përcaktuara, prania e dëmtuesit të specifikuar do të konfirmohet nga një test tjetër molekular pozitiv i renditur në këtë aneks, duke synuar pjesë të ndryshme të gjenomit. Këto teste do të kryhen në të njëjtën mostër bimore ose nëse është e përshtatshme për testin konfirmues molekular të përdorur, në të njëjtin ekstrakt bimor.

7. Identifikimi i nënspecieve të dëmtuesit të specifikuar do të kryhet për çdo specie bimore që gjendet e infektuar nga dëmtuesi i specifikuar në zonën e përcaktuar. Ky identifikim do të kryhet duke përdorur testet molekulare të listuar në pjesën B, të aneksit III të këtij udhëzimi.

8. AKVMB-ja do të raportojë rezultatet e vrojtimeve të përcaktuara në pikën 1, tek autoritetit kompetent i mbrojtjes së bimëve.

Neni 4

Plani i kontigjencës

1. Plani i kontigjencës do të përcaktojë veprimet që duhen ndërmarrë në territorin/zonën, lidhur me:

- a) çrrënjosjen e dëmtuesit të specifikuar, siç parashikohet në nenet 8 deri në 12;
- b) lëvizjen e bimëve të specifikuara brenda vendit, siç parashikohet në nenet 20 deri në 27;
- c) kontrollin zyrtarë që do të kryhet mbi lëvizjet e bimëve të specifikuar brenda territorit të vendit dhe të bimëve bujtëse në vend, siç përcaktohet në nenet 33 dhe 34.

Plani i kontigjencës, sipas rastit, përditësohet deri më 31 dhjetor të çdo viti.

2. Plani i kontigjencës përfshin të gjitha elementet e mëposhtme:

a) burimet minimale që duhen vënë në dispozicion dhe procedurat për vënien në dispozicion të këtyre burimeve shtesë në rast të një pranie të konfirmuar ose të dyshuar të dëmtuesit të specifikuar;

b) rregullat që detajojnë procedurat për identifikimin e pronarëve të bimëve që do të hiqen, për njoftimin e urdhrat të heqjes dhe për të drejtën e hyrjes në pronat private;

c) rolet dhe përgjegjësitë e organeve të përfshira në zbatimin e planit, në rastin e një pranie të konfirmuar zyrtarisht ose të dyshuar të dëmtuesit të specifikuar, si dhe zinxhirin e vendimmarrjes dhe procedurat për koordinimin e masave që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse, institucionet e tjera publike, organet e deleguara ose personat fizikë të përfshirë, laboratorët dhe operatorët profesionist, duke përfshirë koordinimin me shtetet fqinje;

ç) të drejtën e hyrjes së institucionit përgjegjës në ambientet e operatorëve profesionistë, operatorëve të tjerë përkatës dhe persona fizikë;

d) të drejtën e institucionit përgjegjës, kur është e nevojshme, në laboratorë, pajisje, personel, ekspertizë të jashtme dhe burime të nevojshme për çrrënjosjen e shpejtë dhe efektive ose, kur është e përshtatshme, kontrollin e dëmtuesit të specifikuar;

dh) masat që duhen marrë për informimin e autoritetin kompetent të mbrojtjes së bimëve në ministri, rajoneve të tjera të vendit, përdoruesit profesionistë dhe publikut në lidhje me praninë e dëmtuesit të specifikuar dhe masat e marra kundër tij, në rast të konfirmimit zyrtar ose dyshimit për praninë e dëmtuesit të specifikuar;

e) masat për regjistrimin e konstatimeve të pranisë së dëmtuesit të specifikuar;

ë) parimet për ndarjen gjeografike të zonave të shënuar;

f) protokollet që përshkruajnë metodat e kontrollit vizuale, mostrimit dhe analizave laboratorike; dhe

g) parimet lidhur me trajnimin e personelit të institucioneve përgjegjëse dhe sipas rastit, të organeve, autoriteteve publike, laboratorëve, operatorëve profesionistë dhe personave të tjerë të cituar në shkronjën “a” të këtij neni.

Sipas rastit, shkronjat “d” deri në “g” të kësaj pike, marrin formën e manualeve udhëzuese.

KREU III ZONA E SHËNUAR

Neni 5

Krijimi i zonës së shënuar

(Ndryshuar paragrafi i parë, i pikës 1 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Në rast se prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet zyrtarisht te bimët, AKVMB-ja, pa vonesë, përcakton një zonë të shënuar.

Kur konfirmohet vetëm prania e një ose më shumë nëngrupeve të veçanta të dëmtuesit të specifikuar, AKVMB-ja mund të shënojë një zonë vetëm në lidhje me ato nënspecie.

Kur konfirmimi i pranisë së një nëngrupi është në pritje, AKVMB-ja përcakton atë zonë si zonë të shënuar për dëmtuesin e specifikuar dhe të gjitha nënspeciet e tij të mundshme.

2. Zona e shënuar do të përbëhet nga një zonë e infektuar dhe një zonë sigurie.

Zona e infektuar duhet të ketë një rreze prej të paktën 50 m rreth bimës së gjetur të infektuar nga dëmtuesi i specifikuar;

Zona e sigurisë duhet të ketë gjerësinë e mëposhtme:

a) të paktën 2,5 km në rastin e një zone të infektuar të krijuar për qëllimin e marrjes së masave të çrrënjësjes të parashikuara në nenet 8 deri në 12;

b) të paktën 5 km në rastin e një zone të infektuar të krijuar për qëllimin e marrjes së masave të kontrollit të parashikuara në nenet 13 deri në 18.

3. Autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve, publikon dhe përditëson listën e zonave të shënuar të përcaktuara nga AKVMB-ja, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 16, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

Neni 6

Përfshirjet për shpalljen e zonave të shënuara

(Ndryshuar shkronja “a” e pikës 4, shtuar paragraf në shkronjën “b”, të pikës 4 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Përfshirjet nga parashikimet të nenit 5, zona e sigurisë që rrethon zonën e infektuar e krijuar me qëllim çrrënjësjes mund të reduktohet në një gjerësi prej jo më pak se 1 km, kur ekziston një shkallë e lartë besueshmërie, se prania fillestare e dëmtuesit të specifikuar nuk rezulton të jetë i përhapur dhe ku janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha bimët e specifikuara të vendosura në zonën e infektuar, pavarësisht nga statusi i tyre shëndetësor, janë marrë menjëherë dhe janë hequr;

b) asnjë bimë tjetër nuk është gjetur e infektuar nga dëmtuesi i specifikuar në zonën e infektuar që kur janë marrë masat e çrrënjësjes, bazuar në testet zyrtare të kryera të paktën një herë gjatë vitit, duke marrë parasysh skedën e vrojtimit të dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*;

c) është kryer një vrojtım të paktën një herë gjatë vitit të parë pas identifikimit të dëmtuesit të specifikuar në një zonë me gjerësi prej të paktën 2,5 km që rrethon zonën e infektuar, e cila tregon se dëmtuesi i specifikuar nuk është hasur në atë zonë. AKVMB-ja merr mostra dhe teston bimët bujtëse të vendosura në atë zonë në ISUV, bazuar në rrezik të *Xylella fastidiosa*, përcaktimi i skemave të vrojtimit dhe mostrimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë me të paktën 90% besueshmëri, një nivel të pranishmërisë së bimëve të infektuara prej 1%, duke marrë parasysh që 400 m e parë që rrethon bimët e infektuara ka një rrezik më të lartë në krahasim me pjesën tjetër të asaj zone;

ç) asnjë vektor që mbart dëmtuesin e specifikuar nuk është zbuluar në zonën e infektuar dhe në afërsi të kësaj zone, që kur janë marrë masat e çrrënjësjes, në bazë të testeve të kryera dy herë gjatë sezonit të fluturimit të vektorit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare. Këto teste konfirmojnë që përhapja natyrale e dëmtuesit të specifikuar përjashtohet.

2. Kur zvogëlohet gjerësia e zonës së sigurisë sipas pikës 1 të këtij neni, AKVMB-ja njofton menjëherë autoritetin kompetent të mbrojtjes së bimëve, mbi arsyetimin për këtë reduktim.

3. Përfshirjet nga parashikimet e nenit 5, autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve në bashkëpunim me AKVMB-në mund të vendosë të mos krijojë një zonë të shënuar menjëherë, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ka prova që dëmtuesi i specifikuar është futur së fundmi në zonën me bimët në të cilat është gjetur ose se dëmtuesi i specifikuar është gjetur në një vend me mbrojtje fizike nga vektorët e atij dëmtuesi;

b) rezultatet e aktiviteteve të inspektimit tregojnë se ato bimë janë infektuar përpara hyrjes së tyre në atë zonë;

c) nuk është zbuluar asnjë vektor që mbart dëmtuesin e specifikuar, në bazë të testeve të kryera në afërsi të këtyre bimëve.

4. Në rastin e cituar në pikën 3 të këtij neni, AKVMB-ja, do të:

a) të kryejë, në zonën ku prania e dëmtuesit të specifikuar u konfirmua për herë të parë, një vrojtim vjetor për të paktën 1 vit, me qëllim përcaktimin nëse ndonjë bimë tjetër është infektuar dhe nëse duhen marrë masa të mëtejshme;

b) të njoftojë autoritetin kompetent të mbrojtjes së bimëve, me argumentimin për moscaktimin e zonës si zonë e shënuar dhe rezultatin e vrojtimit të përcaktuar në shkronjën “a” sapo të jetë i disponueshëm.

Vrojtimi i përmendur në shkronjën “a” përfshin mostrat e mbledhura për testim duke përdorur një nga testet molekulare të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi. Modeli i vrojtimit dhe skema e mostrimit duhet të mundësojnë identifikimin, me të paktën 90% besueshmëri, të një niveli pranie prej 1/% të bimëve të infektuara.

Neni 7

Heqja e shpalljes zonë e shënuar

1. Kur në bazë të vrojtimeve të parashikuara në nenin 11, dëmtuesi i specifikuar nuk është zbuluar në një zonë të shënuar për një periudhë katërvjeçare, statusi i zonës si zonë e shënuar mund të hiqet. Në raste të tilla, autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve njofton Komisionin dhe vendet që kërkojnë njoftim sipas rregullave të tyre të brendshme.

2. Përjashtimisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, në rastin kur AKVMB-ja ka reduktuar zonën e sigurisë në një gjerësi prej jo më pak se 1 km në përputhje me pikën 1 të nenit 6, autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve mund të heqë zonën e shënuar pas 12 muajsh nga shpallja fillestar, kur plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) si rezultat i masave të marra në përputhje me pikën 1, të nenit 6, garantohej një shkallë të lartë besueshmërie se prania fillestare e dëmtuesit të specifikuar ishte një rast i izoluar dhe nuk ka ndodhur asnjë përhapje e mëtejshme në zonën përkatëse të shënuar;

b) praktikisht afër kohës së heqjes, janë kryer teste zyrtare brenda zonës së shënuar, duke marrë parasysh Skedën e Vrojtimit të Dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*. Për këtë qëllim dhe duke marrë parasysh udhëzimet për vrojtimit statistikisht të qëndrueshme dhe të bazuar në rrezikun e *Xylella fastidiosa*, përcaktimi i skemave të vrojtimit dhe mostrimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë me të paktën 95% besueshmëri, një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%.

3. Kur një zonë e shënuar hiqet në përputhje me pikën 2 të këtij neni, bimët e specifikuara të vendosura në zonën e shënuar më parë do t'u nënshtrohen studimeve intensive gjatë dy viteve në vijim. Për këtë qëllim, dhe duke marrë parasysh udhëzimet për vrojtimit statistikisht të qëndrueshme dhe të bazuar në rrezikun ndaj *Xylella fastidiosa*, përcaktimi i skemave të vrojtimit dhe mostrimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri, një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%.

4. Kur hiqet statusi si zonë e shënuar pas 12 muajsh nga identifikimi i saj fillestar, autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve, njofton menjëherë Komisionin dhe vendet që kërkojnë njoftim sipas rregullave të tyre të brendshme, për arsyetimin për këtë heqje.

KREU IV

MASAT PËR ÇRRËNJOSJEN

Neni 8

Heqja e bimëve

(Ndryshuar shkronja “d” e pikës 1, paragrafi i parë i pikës 3 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja heq menjëherë nga zona e infektuar:
 - a) bimët që dihet se janë të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar;
 - b) bimët që shfaqin simptoma që tregojnë infeksion të mundshëm nga dëmtuesi i specifikuar ose që dyshohet se janë të infektuara nga ky dëmtues;
 - c) bimët që i përkasin të njëjtës specie si ajo e bimës së infektuar, pavarësisht nga statusi i tyre shëndetësor;
 - ç) bimë të llojeve të tjera nga ajo e bimës së infektuar, të cilat janë gjetur të infektuara në pjesë të tjera të zonës së shënuar;
 - d) Bimët e specifikuara, përveç atyre të përmendura në shkronjat “c” dhe “ç”, të cilat nuk i janë nënshtruar menjëherë marrjes së mostrave dhe testimit molekular.

Bimët e specifikuara të përmendura në paragrafin e parë të kësaj shkronje, të cilat kanë rezultuar negative për praninë e dëmtuesit të specifikuar, nuk hiqen.

Përfshirja nga paragrafi i parë i kësaj pike, AKVMB-ja mund të vendosë të mos i nënshtrohet menjëherë marrjes së mostrave dhe testimit ato bimë të specifikuara që nuk janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në atë zonë të shënuar gjatë dy viteve të fundit, bazuar në rezultatet e marrjes së mostrave dhe testimit të kryer në përputhje me paragrafin e parë të kësaj shkronje dhe vërtetimet sipas nenit 11 të këtij udhëzimi. Megjithatë, këto bimë do t'u nënshtrohen vërtetimeve vjetore të kryera në përputhje me nenin 11 të këtij udhëzimi.

2. Kur hiqen bimët e cituara në pikën 1 të këtij neni, AKVMB-ja merr të gjitha masat e nevojshme paraprake dhe organizon heqjen në bazë të nivelit të rrezikut që paraqesin ato bimë.

3. Me përjashtim nga shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, AKVMB-ja mund të vendosë të mos i heqin bimët të specifikuara individuale që janë caktuar zyrtarisht si bimë me vlerë historike ose pemë me vlerë të veçantë shoqërore, kulturore apo mjedisore, prerja e të cilave do të kishte një ndikim të papranueshëm, ose që i nënshtrohen rregullave të veçanta kombëtare për mbrojtjen e tyre, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme.

a) bimët e specifikuara në fjalë i nënshtrohen inspektimit, marrjes së mostrave dhe testimit vjetor me një praj testeve molekulare të listuara në aneksin III të këtij udhëzimi dhe konfirmohet se ato nuk janë të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar;

b) bimët individuale të specifikuara ose zona në fjalë i nënshtrohen trajtimeve të përshtatshme fitosanitare kundër vektorëve të dëmtuesit të specifikuar në të gjitha fazat e tij. Këto trajtime mund të përfshijnë metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike, duke marrë parasysh kushtet lokale.

Neni 9

Masat kundër vektorëve të dëmtuesit të specifikuar

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Në zonën e infektuar, AKVMB-ja zbaton trajtime fitosanitare të përshtatshme kundër të gjitha stadeve të popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar. Në veçanti, duhet të aplikojë këto trajtime para dhe gjatë heqjes së bimëve të përmendura në pikën 1, të nenit 8, gjatë sezonit të fluturimit të vektorëve. Këto praktika duhet të përfshijnë trajtime efikase kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, duke marrë parasysh kushtet lokale.

2. AKVMB-ja duhet të zbatojë:

a) në zonat bujqësore, në zonën e infektuar dhe në zonën e sigurisë, praktikat bujqësore për kontrollin e popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar, në të gjitha stadet e tij, në kohën më të përshtatshme të vitit, pavarësisht nga heqja e bimëve përkatëse;

b) në zonat që nuk janë bujqësore, të paktën në zonat e infektuara, masat për kontrollin e popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar, në të gjitha stadet e tij, në kohën më të përshtatshme të vitit, pavarësisht nga heqja e bimëve përkatëse;

c) praktikat bujqësore të përmendura në shkronjën “a” dhe masat e përmendura në shkronjën “b” duhet të përfshijnë trajtime efektive kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, sipas rastit, duke marrë parasysh kushtet lokale.

Neni 10

Shkatërrimi i bimëve

(Shtuar pika 3 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja shkatërron bimët dhe pjesët bimore të parashikuara në pikën 1, të nenit 8, për të siguruar që dëmtuesi i specifikuar të mos përhapet, në vend ose në një vendndodhje të afërt të caktuar për këtë qëllim brenda zonës së infektuar ose me kusht që bimët ose pjesët bimore të mbulohen me rrjetë kundër vektorëve, që janë më afër me vendin e infektuar.

2. AKVMB-ja mund të vendos në bazë të nivelit të rrezikut, të kufizojë shkatërrimin vetëm të degëve dhe gjetheve dhe drurit t'i nënshtrohet një trajtimi fitosanitar përkatës siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 9. Sistemi rrënjor i këtyre bimëve ose duhet të hiqet ose të thahet me një trajtim të përshtatshëm fitosanitare për të shmangur mbirjen.

3. Në rastin kur AKVMB-ja vendos të mos asgjësojë drurin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, ai duhet të sigurohet që druri të jetë i pastër nga gjethet dhe degët.

Neni 11

Mbikëqyrja vjetore e zonës së shënuar

Në zonën e shënuar AKVMB-ja monitoron, në kohë të përshtatshme, praninë e dëmtuesit të specifikuar nga vërtetimet vjetore, sipas pikave 5 dhe 6, të nenit 3 dhe duke marrë parasysh informacionin që i referohet Skedës së Vërtimit të Dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*.

Në zonat e infektuara AKVMB-ja merr mostra dhe teston bimët bujtëse në ISUV duke përfshirë bimët e specifikuara që nuk janë hequr sipas pikës 1, të nenit 8. Përcaktimi i skemës së vërtimit dhe mostrimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë të paktën 90% besueshmëri, një nivel pranije të bimëve të infektuara prej 0,5%.

Në zonat e sigurisë AKVMB-ja merr mostra dhe teston në ISUV, bimët bujtëse, si dhe bimë të tjera, që shfaqin simptoma ose dyshohet se janë të infektuara nga ky dëmtues. Për këtë qëllim, përcaktimi i skemës së vërtimit dhe mostrimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë të paktën 90% besueshmëri, një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%, duke pasur parasysh se 400 m e para që rrethojnë zonat e infektuara kanë një rrezik më të lartë.

AKVMB-ja monitoron gjithashtu praninë e dëmtuesit të specifikuar në vektorët e vendosur në zonën e përcaktuar me qëllim që të përcaktojë rrezikun e përhapjes së mëtejshme të shkaktuar nga vektorët dhe të vlerësojë efektivitetin e masave të kontrollit fitosanitar të zbatuara në përputhje me nenin 9.

Neni 12

Masat e tjera përkatëse për çrrënjosjen e dëmtuesit të specifikuar

1. AKVMB-ja merr çdo masë tjetër që mund të kontribuojë në çrrënjosjen e dëmtuesit të specifikuar në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare (ISPM 9) dhe për të kontribuar në zbatimin e një qasje të integruar në përputhje me parimet e përcaktuara në ISPM 14.

2. AKVMB-ja merr masa për adresimin e çdo veçorie ose ndërlikimi që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të parandalojë, pengojë ose vonojë çrrënjosjen, veçanërisht ato që lidhen me shkatërrimin e duhur të të gjitha bimëve që janë të infektuara ose të dyshuara për infeksion ose për leje hyrje në vendndodhje, pronësinë publike ose private ose subjektin përgjegjës.

3. AKVMB-ja kryen hetimet e duhura për të identifikuar origjinën e infeksionit. Gjurmën e bimëve bujtëse të lidhura me rastin e infeksionit duke përfshirë ato që janë zhvendosur përpara se të krijohej një zonë e shënuar. Rezultatet e hetimeve do t'i komunikohen autoritetit kompetent të mbrojtjes së bimëve.

KREU V MASAT E KUFIZIMIT

Neni 13

Dispozitat e përgjithshme

AKVMB-ja mund të vendosë të zbatojë masat e kontrollit të përcaktuara në nenet 14 deri në 18, në vend të masave të çrrënjosjes në një zonë të infektuar.

Neni 14

Heqja e bimëve nga një zonë e infektuar

1. AKVMB-ja heq të gjitha bimët që janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në bazë të monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 16.

Heqja bëhet menjëherë pas identifikimit zyrtar të pranisë së dëmtuesit të specifikuar ose nëse dëmtuesi i specifikuar zbulohet jashtë sezonit të fluturimit të vektorit, heqja do të bëhet përpara sezonit të ardhshëm të fluturimit të vektorit. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur përhapjen e dëmtuesit të specifikuar dhe vektorëve të tij gjatë dhe pas heqjes.

2. Përjashtimisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, AKVMB-ja mund të vendosë, për qëllime shkencore, të mos heqë bimët që janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në vendet me bimë me vlerë të veçantë kulturore dhe sociale, referuara shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 16.

Neni 15

Masat kundër vektorëve të dëmtuesve të specifikuar në zonat e infektuara

(Ndryshuar pika 1 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja zbaton trajtime fitosanitare të përshtatshme kundër të gjitha stadeve të popullatës së vektorit të dëmtuesit të specifikuar mbi bimët e përmendura në pikën 1, të nenit 14 të këtij udhëzimi, përpara heqjes së tyre, veçanërisht gjatë sezonit të fluturimit të vektorëve, si dhe përreth bimëve të përmendura në pikën 2, të nenit 14 të këtij udhëzimi. Këto trajtime duhet të përfshijnë metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, duke marrë parasysh kushtet lokale.

2. Në zonat e cituara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2 të nenit 16, AKVMB-ja zbaton praktikën bujqësore për kontrollin e popullatës së vektorëve të dëmtuesit të specifikuar, në të gjitha fazat e tij, në kohën më e përshtatshme të çdo vitit. Këto praktika do të përfshijnë trajtime efikase kimike, biologjike ose mekanike kundër vektorëve, duke marrë parasysh kushtet lokale.

Neni 16

Mbikëqyrja vjetore e zonave të infektuara

(Ndryshuar shkronja "a" e pikës 2 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Në rast shfaqje të infeksionit nga ky dëmtuesi, AKVMB-ja merr menjëherë mostra të zona të infektuara dhe i dërgon për testim në ISUV, brenda një rrezeje prej 50 m rreth bimëve që janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar, si bimët e mëposhtme:

a) të gjitha bimët e specifikuar që i përkasin specieve të bimëve të specifikuar të cilat janë gjetur të infektuara në të njëjtën zonë të shënuar, dhe;

b) të gjitha bimët e tjera që shfaqin simptoma që tregojnë infeksion të mundshëm nga ky dëmtues ose që dyshohet se janë të infektuara nga ky dëmtues.

2. AKVMB-ja monitoron, në kohën më të përshtatshme, praninë e dëmtuesit të specifikuar nga vërtetimet vjetore, duke marrë parasysh informacionin e referuar në Skedën e Vërtetimit të Dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*. Ky monitorim bëhet të paktën në pjesët e mëposhtme të zonës së infektuar:

a) brenda një zone me përmasa prej të paktën 2 km nga kufiri i zonës së infektuar me zonën e sigurisë;

b) në afërsi të zonave të bimëve me vlerë të veçantë kulturore dhe sociale të vendosura jashtë zonës së përmendur në shkronjën "a" dhe të përcaktuara në përputhje me rrethanat e rajonit përkatës.

Në ato pjesë të zonës së infektuar, AKVMB-ja do të kryejë marrjen e mostrave dhe testimin e specieve të bimëve bujtëse të hasura të infektuara në zonën e përcaktuar, në përputhje me pikën 6, të nenit 3. Për këtë qëllim, përcaktimi i skemave të vërtetimit dhe e marrjes së mostrave duhet të jetë në gjendje të identifikojë me të paktën 90% besueshmëri, një nivel pranije të bimëve të infektuara prej 0,7%. Gjithashtu do të marrë mostra dhe të dërgoj për testim popullatën e vektorëve për praninë e dëmtuesit të specifikuar.

3. Në zonat e sigurisë, AKVMB-ja do të marrë mostra dhe dërgon për testim bimët bujtëse në ISUV, si dhe bimët e tjera që shfaqin simptoma që tregojnë infeksion të mundshëm nga ky dëmtues ose që dyshohet se janë të infektuara nga ky dëmtues. Për këtë qëllim, përcaktimi i skemës së vërtetimit dhe testimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë me të paktën 90% besueshmëri, një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%, duke marrë parasysh se 400 m e parë ngjitur me zonat e infektuara përbëjnë një rrezik më të lartë.

4. AKVMB-ja monitoron praninë e dëmtuesve të specifikuar në vektorë në pjesët e zonës së infektuar të cituar në pikën 2, të këtij neni dhe në zonën e sigurisë me qëllim që të përcaktojë rrezikun e përhapjes së mëtejshme të shkaktuar nga vektorët dhe të vlerësojë efektivitetin e masave të kontrollit fitosanitar të zbatuar në përputhje me nenin 15.

Neni 17

Shkatërrimi i bimëve

(Shtuar pika 3 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja në vend ose në një vendndodhje të afërt të caktuar për këtë qëllim brenda zonës së infektuar, shkatërron bimët dhe pjesët e bimëve që janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar, në një mënyrë që siguron që dëmtuesi i specifikuar të mos përhapet.

2. AKVMB-ja mund të vendosë të kufizojë shkatërrimin vetëm të degëve dhe gjetheve dhe druri t'i nënshtrohet një trajtimi të përshtatshëm fitosanitar përkatës në përputhje me pikën 1 të nenit 15, ku konstatohet se ato bimë nuk paraqesin ndonjë rrezik për përhapjen e mëtejshme të dëmtuesit të

specifikuar. Sistemi rrënjor i këtyre bimëve ose hiqet ose thahet me një trajtim të përshtatshëm fitosanitar për të shmangur mbirjen.

3. Kur AKVMB-ja vendos të mos e asgjësojë drurin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, duhet të verifikojë që druri të jetë i pastër nga gjethet dhe degët.

Neni 18

Masat të tjera përkatëse për kontrollin e dëmtuesit të specifikuar

AKVMB-ja merr masa për të adresuar çdo veçori ose ndërlikim që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të parandalojë, pengojë ose vonojë frenimin, në veçanti ato që kanë të bëjnë me shkatërrimin të përshtatshëm për të gjitha bimët që janë të infektuara ose të dyshuara për infektim ose me aksesin në vendndodhjen e tyre, pronësinë publike/private ose personi ose subjektin përgjegjës.

KREU VI

MBJELLJA E BIMËVE TË SPECIFIKUARA NË ZONAT E INFEKTUARA

Neni 19

Autorizimi në lidhje me mbjelljen e bimëve të specifikuara në zona të infektuara

(Ndryshuar shkronja “b” dhe “c”, shtuar shkronja “ç” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Mbjellja e bimëve të specifikuara në zonat e infektuara mund të autorizohet nga AKVMB-ja vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) këto bimë të specifikuara janë rritur në vende prodhimi të mbrojtura nga insektet, të pastra nga dëmtuesi i specifikuar dhe vektorët e tij;

b) këto bimë të specifikuara mbillen ose shatohen në zonat e infektuara, por jashtë zonës së përmendur në shkronjën “a”, pikën 2, të nenit 16 të këtij udhëzimi, dhe preferohet të jenë të kultivarëve që janë vlerësuar si rezistentë ose tolerantë ndaj dëmtuesit të specifikuar, ose të jenë të së njëjtës specie bimësh që janë testuar dhe rezultuar të pastra nga dëmtuesi i specifikuar, mbi bazën e vërtetimit të kryera në zonën e infektuar të paktën gjatë dy viteve të fundit;

c) këto bimë të specifikuara i përkasin të njëjtës specie bimë që është testuar dhe kanë rezultuar të pastra nga dëmtuesi i specifikuar, mbi bazën e veprimtarive të vërtetimit të kryera për të paktën dy vitet e fundit në përputhje me nenin 11, dhe rimbillen në zonat e infektuara të përcaktuara për qëllime çrrënjësje.

ç) bimë të specifikuara, përveç atyre të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni, mund të mbillen për qëllime shkencore, me kusht që të mbillen jashtë zonave të përmendura në paragrafin e parë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 16 të këtij udhëzimi.

KREU VII

LËVIZJA E BIMËVE TË SPECIFIKUARA BRENDË TERRITORIT TË VENDIT

Neni 20

Lëvizja nga një zonë e shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonën e sigurisë të bimëve të specifikuara që janë rritur në vendet e autorizuar të prodhimit të vendosura në atë zonë të shënuar

Lëvizja jashtë zonës së shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë, të bimëve të specifikuara që janë rritur në një vend prodhimi të vendosur në atë zonë të shënuar, mund të lejohet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bimët e specifikuara janë kultivuar gjatë gjithë ciklit të tyre të prodhimit në një vend që është miratuar në përputhje me nenin 25 të këtij udhëzimi ose kanë qenë të pranishme në një vend të tillë për të paktën 1 vit;

b) gjatë gjithë kohës së rritjes së bimëve të specifikuara, as prania e dëmtuesit të specifikuar dhe as e vektorët e tij nuk u gjetën në vend;

c) bimët e specifikuara i nënshtrohen trajtimeve fitosanitare kundër popullatës së vektorëve, në të gjitha fazat e saj, në periudha të përshtatshme të vitit për të ruajtur pastërtinë nga vektorët e dëmtuesit të specifikuar. Këto trajtime do të përfshijnë, sipas rastit, metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike, duke marrë parasysh kushtet lokale;

ç) bimët e specifikuara transportohen përmes ose brenda zonës së shënuar në kontejnerë ose ambalazhe të mbyllura, duke siguruar që infeksioni me dëmtuesin e specifikuar ose ndonjë nga vektorët e tij nuk është hasur;

d) sa më afër që të jetë e mundur me kohën e lëvizjes, bimët e specifikuara i janë nënshtruar testimit molekular për praninë e dëmtuesit të specifikuar në bazë të një testi të renditur në aneksin III të këtij udhëzimi duke përdorur një skemë mostrimi të aftë për të identifikuar me të paktën 80% besueshmëri, një nivel i pranishëm së bimëve të infektuara prej 1%.

Neni 21

Lëvizja nga një zonë e shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë të bimëve të specifikuara që nuk janë gjetur kurrë të infektuara në atë zonë të shënuar

Lëvizja jashtë zonës së shënuar dhe nga zona përkatëse e infektuar në zonat e sigurisë, e bimëve të specifikuara që nuk janë gjetur kurrë të infektuara në atë zonë të shënuar, mund të lejohet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bimët e specifikuara janë rritur në një zonë që i përket një operatori profesionist të regjistruar në përputhje me nenin 6/1, të ligjit nr. 105/2016 "*Për mbrojtjen e bimëve*", të ndryshuar;

b) bimët e specifikuara i përkasin llojeve të bimëve të cilat janë rritur për të paktën një pjesë të jetës së tyre në një zonë të shënuar dhe i janë nënshtruar, gjatë tre viteve nga shpallja e zonës së shënuar, për të vërtetuar aktivitetet të përcaktuara në nenet 11 dhe 16 dhe nuk u gjet kurrë të infektuar me dëmtuesin e specifikuar;

c) speciet e bimëve të specifikuara të përmendura në shkronjën "b" publikohen në bazën e të dhënave të autoritetit kompetent të mbrojtjes së bimëve, për bimët bujtëse të cilat nuk dihet se janë të infektuara në atë zonë specifike të shënuar;

ç) bimët e specifikuara i nënshtrohen trajtimeve fitosanitare kundër popullatës vektorëve, në të gjitha fazat e saj, në periudha të përshtatshme të vitit për të ruajtur pastërtinë nga vektorët e dëmtuesit të specifikuar. Këto trajtime do të përfshijnë, sipas rastit, metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike bazuar në kushtet lokale;

d) praktikisht sa më afër kohës së lëvizjes, lotet e bimëve të specifikuara ju nënshtruan inspektimit nga AKVMB-ja dhe testimit molekular nga ISUV-i, duke përdorur një skemë mostrimi të aftë për të identifikuar me të paktën 95% besueshmëri, një nivel të pranishëm së bimëve të infektuara prej 1%;

dh) praktikisht sa më afër kohës së lëvizjes, lotet e bimëve të specifikuara ju nënshtruan trajtimeve fitosanitare kundër të gjithë vektorëve të dëmtuesit të specifikuar.

Neni 22

Lëvizja nga një zonë e shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë, të bimëve të specifikuara që janë rritur për të gjithë ciklin e prodhimit në *in-vitro* në atë zonë të shënuar

Lëvizja jashtë zonës së shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë, të bimëve të specifikuara që janë rritur gjatë gjithë ciklit të prodhimit në *in-vitro* në atë zonë të shënuar, mund të lejohet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bimët e specifikuara janë rritur në gjithë ciklin e tyre të prodhimit në një vend që është autorizuar në përputhje me nenin 25;

b) bimët e specifikuara janë rritur në një enë transparente në kushte sterile dhe plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

i) ato janë rritur nga farat;

ii) ato janë shumuar, në kushte sterile nga bimët mëmë të cilat kanë kaluar gjithë jetën e tyre në një zonë të vendit të pastër nga dëmtuesi i specifikuar dhe që janë testuar dhe janë gjetur të pastra nga dëmtuesi i specifikuar;

iii) ato janë shumuar, në kushte sterile, nga bimët mëmë që janë rritur në një zonë që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 20 dhe të cilat janë testuar dhe janë gjetur të pastra nga dëmtuesi i specifikuar duke përdorur një skemë mostrimi të aftë për të identifikuar me të paktën 95% besueshmëri, një nivel i pranisë së bimëve të infektuara prej 1%;

c) bimët e specifikuara transportohen përmes ose brenda zonave të shënuar në një kontejner në kushte sterile që përjashtojnë mundësinë e infektimit nga dëmtuesi i specifikuar nëpërmjet vektorëve të tij.

Neni 23

Lëvizja nga një zonë e shënuar dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë të bimëve të rrushit (*vitis*) në fazën e qetësisë të cilat janë rritur për një pjesë të jetës së tyre në atë zonë të shënuar

Lëvizja nga zona e shënuar, dhe nga zonat përkatëse të infektuara në zonat e sigurisë, të bimëve të rrushit (*Vitis*) në fazën e qetësisë të destinuara për mbjellje, përveç farave, të cilat janë rritur për një pjesë të jetës së tyre në atë zonë të shënuar dhe janë të listuara si bimë të specifikuara për atë zonë të shënuar, mund të lejohen vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bimët janë rritur në një zonë që i përket një operatori të regjistruar në përputhje me nenin 6/1 të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar;

b) praktikisht sa më afër kohës së lëvizjes, bimët i janë nënshtruar një trajtimi të përshtatshëm termoterapia në një objekt trajtimi të autorizuar dhe të mbikëqyrur nga AKVMB-ja, ku bimët në fazën e qetësisë zhyten për 45 minuta në ujë të ngrohur në 50°C.

Neni 24

Lëvizja brenda zonës së infektuar, brenda zonës së sigurisë dhe nga zonat e sigurisë në zonat e tyre përkatëse të infektuara, të bimëve të specifikuara që janë rritur për një pjesë të jetës së tyre në një zonë të shënuar

(Ndryshuar shkronja “a” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Lëvizja brenda zonës së infektuar, brenda zonës së sigurisë dhe nga zonat e sigurisë në zonat e tyre përkatëse të infektuara, të bimëve të specifikuara që janë rritur për të paktën një pjesë të jetës së tyre në një zonë të kufizuar, mund të lejohet vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Bimët e specifikuara janë kultivuar në një vend që i përket një operatori të regjistruar në përputhje me nenin 6/1, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe në rastin e një zone të infektuar, vendi përmbush kërkesat e nenit 19 të këtij udhëzimi;

b) vendi i nënshtrohet marrjes së mostrave dhe testimit vjetor për praninë e dëmtuesit të specifikuar duke marrë parasysh informacionin e përcaktuar në skedën e vrojtimit të dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*;

c) rezultatet e inspektimit vjetor dhe të testimit të një mostre përfaqësues konfirmojnë mungesën e dëmtuesit të specifikuar;

ç) bimët e specifikuara i nënshtrohen trajtimeve fitosanitare kundër popullatës së vektorëve, në të gjitha fazat e saj, në periudha të përshtatshme të vitit për të ruajtur pastërtinë nga vektorët e dëmtuesit të specifikuar. Këto trajtime do të përfshijnë, sipas rastit, metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike, duke marrë parasysh kushtet lokale;

d) operatorët profesionistë do t’i kërkojnë personit që i pranon ato bimë të nënshkruajë një deklaratë se ato bimë nuk do të zhvendosen nga ato zona.

Neni 25

Miratimi i zonave të prodhimit

(Ndryshuar shkronja “b” dhe “c” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja mund të miratojë një vend prodhimi për qëllimet e neneve 20 dhe 22, vetëm kur plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) është regjistruar në përputhje me nenin 6/1, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar;

b) është një vendndodhje fizikisht e mbrojtur kundër dëmtuesit të specifikuar dhe transmetuesve të tij;

c) i është nënshtruar të paktën dy inspektimeve vjetore nga AKVMB-ja në kohën më të përshtatshme, ku inspektimi i fundit përfshin marrjen e mostrave dhe testimin sa më afër kohës së lëvizjes.

2. Kur gjatë inspektimeve vjetore, AKVMB-ja do të zbulojë praninë e dëmtuesit të specifikuar ose dëmtime në mbrojtjen fizike të përmendur në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, ato do të revokojnë menjëherë autorizimin e zonës dhe do të pezullojnë përkohësisht lëvizja e bimëve të specifikuara jashtë zonës së shënuar dhe nga zona përkatëse të infektuar në zonën e sigurisë.

3. AKVMB-ja për çdo rajon do të krijojë dhe përditësojë një listë me të gjitha vendet të autorizuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Kjo listë i dërgohet autoritetit kompetent të mbrojtjes së bimëve, menjëherë pas krijimit ose përditësimit të kësaj liste.

Neni 26

Lëvizja brenda territorit të vendit të bimëve të specifikuara të cilat nuk janë rritur në një zonë të shënuar

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 2 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Bimët e specifikuara që nuk janë rritur kurrë brenda një zone të shënuar mund të zhvendosen vetëm brenda territorit të vendit, kur janë rritur në një zonë që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) i përket një operatori profesionist të regjistruar në përputhje me nenin 6/1, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar dhe i nënshtrohet inspektimit vjetor nga AKVMB-ja;

b) i nënshtrohet, sipas rastit për nivelin e rrezikut, marrjes së mostrave dhe testimit për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke përdorur një test të listuar në aneksin III të këtij udhëzimi dhe duke marrë parasysh informacionin e përcaktuar në Skedën e Vrojtimit të Dëmtuesit për *Xylella fastidiosa*.

2. Përfshihet nga pika 1, bimët për mbjellje, përveç farërave, të *Coffea*, *Lavandula dentata* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L. dhe *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Ëëbb, mund të lëvizin për herë të parë brenda vendit vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ato janë rritur në një vend që i nënshtrohet inspektimit vjetor nga AKVMB-ja;

b) vendi i nënshtrohet marrjes së mostrave dhe testimit për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke marrë parasysh informacionin e përcaktuar në Skedën e Vrojtimit të Dëmtuesit për *Xylella fastidiosa* dhe duke përdorur një skemë mostrimi në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri, një nivel i pranishëm së bimëve të infektuara prej 1%.

Neni 27

Lëvizja brenda vendit të bimëve mëmë parabazë ose materiale parabazë, të cilat janë rritur jashtë zonës së shënuar

Bimët mëmë parabazë ose materiali parabazë, të cilat i përkasin specieve *Juglans regia* L., *Olea europaea* L., *Prunus amygdalus* Batsch P. *amygdalus* x *P. persica*, *P. armeniaca* L., *P. avium* (L.) L., *P. cerasus* L., *P. domestica* L., *P. domestica* x *P. salicina*, *P. dulcis* (Mill.)

DA Ëëbb, *P. persica* (L.) Batsch dhe *P. salicina* Lindley dhe që janë rritur jashtë zonës së shënuar dhe kanë kaluar të paktën një pjesë të jetës së tyre jashtë objekteve me rrjet mbrojtëse kundër insekteve, mund të zhvendosen vetëm brenda vendit kur ata shoqërohen me pasaportë bimore ose certifikatë fitosanitare të brendshme dhe janë plotësuar këto kushte:

a) ato janë certifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për materialin mbjellës;

b) brenda një kohe sa më të shkurtër përpara lëvizjes së tyre, ato i janë nënshtrohet inspektimit vizual, marrjes së mostrave dhe testimit molekular për praninë e dëmtuesit të specifikuar, të kryera në përputhje me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare.

Neni 28

Pasaporta e bimore

(Ndryshuar shkronja “b” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Bimët e cituara në nenet 20 deri në 27 do të zhvendosen brenda territorit të vendit vetëm nëse shoqërohen me një pasaportë bimore/certifikatë fitosanitare e brendshme.

Në rastin e bimëve të specifikuara të përmendura në nenin 24, do të zbatohen kushtet e mëposhtme shtesë:

a) në rastin kur ato lëvizin vetëm brenda zonave të infektuara, treguesi “Zonë e infektuar-XYLEFA” do të përfshihet pranë kodit të gjurmueshmërisë të cituar në pasaportë bimore ose certifikatë fitosanitare të brendshme;

b) Në rastin kur lëvizin brenda zonës së sigurisë, ose nga zona e sigurisë në zonën e infektuar, pranë kodit të gjurmueshmërisë të përmendur në shkronjën “c”, të pikës 1, të pjesës A, të aneksit IV, të urdhrin nr. 274, datë 5.5.2023, “Për procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t’u miratuar për lëshimin e pasaportës bimore, si dhe rastet e heqjes së miratimit”, duhet të përfshihet shënimi “Zona e Sigurisë – XYLEFA”.

KREU VIII
IMPORTI I BIMËVE BUJTËSE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 29

Hyrja në territorin e vendit të bimëve bujtëse me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se dëmtuesi i specifikuar nuk është i pranishëm

(Ndryshuar shkronja “a” dhe “ç” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Bimët bujtëse me origjinë nga vendet e tjera, ku dihet se dëmtuesi i specifikuar nuk është i pranishëm, mund të hynë në territorin e vendit, vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Autoriteti Kompetent i Mbrojtjes së Bimëve të vendit tjetër, përveç atyre të BE-së i ka komunikuar me shkrim Komisionit Evropian se dëmtuesi i specifikuar dihet se nuk është i pranishëm në vend, dhe kjo deklaratë është publikuar në faqen zyrtare të BE-së “*Deklarata nga vendet jo anëtare të BE-së në lidhje me statusin e Xylella fastidiosa*”. Në rast se një deklaratë e tillë nuk është e publikuar, autoriteti kompetent i vendit tjetër njofton me shkrim Autoritetin Kompetent të Mbrojtjes së Bimëve në Ministri të vendit tonë, se dëmtuesi i specifikuar dihet se nuk është i pranishëm në vend, bazuar në inspektim, marrje mostrash dhe testim molekular nga autoriteti kompetent, duke përdorur një test të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe në përputhje me ISPM nr. 4 (*) dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e autoritetit për vrojtime statistikisht të sakta dhe të bazuara në risk për *Xylella fastidiosa*, përcaktimi i skemës së vërtetimit dhe mostrimit të përdorura janë në gjendje të identifikojnë një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, një nivel të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar.

Për vendet e BE-së statusi në lidhje me *Xylella fastidiosa*, do të verifikohet në faqen zyrtare të BE-së për *Xylella fastidiosa*”: (*) ISPM nr. 4 “Kërkesat për krijimin e zonave të pastra nga dëmtuesit.

b) bimët bujtëse shoqërohen nga një certifikatë fitosanitare që citon në rubrikën “Deklaratë Shtesë” se dëmtuesi i specifikuar nuk është i pranishëm në vend;

c) bimët bujtëse janë rritur në një vend që i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent dhe sipas rastit për nivelin e rrezikut, me marrjen e mostrave dhe testimin, të përcaktuara në aneksin III të këtij udhëzimi, të kryera në kohën e duhur në ato bimë për praninë e dëmtuesit të specifikuar;

ç. Bimët për mbjellje, përveç farave, të llojeve *Coffea* L., *Lavandula angustifolia* Mill., *Lavandula dentata* L., *Lavandula x intermedia* Emeric ex Loisel., *Lavandula latifolia* Medik., *Lavandula stoechas* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L., *Prunus dulcis* (Mill.) D.A.Ëëbb dhe *Salvia rosmarinus* Spenn. që janë kultivuar në një vend që i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent, me marrje mostrash dhe teste, të listuar në aneksin III të këtij udhëzimi, kryer në kohët e përshtatshme për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke përdorur një skemë mostrimi që është në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri me një nivel të pranisë së bimëve të infektuara prej 1%.

Neni 30

Hyrja në territorin e vendit të bimëve bujtëse me origjinë nga një zonë të pastër dëmtuesi të një vendi të infektuar

(Ndryshuar shkronja “a”, “c” dhe “d” me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

Bimët bujtëse me origjinë nga një vend tjetër ku dihet se është i pranishëm dëmtuesi i specifikuar mund të hynë në territorin e vendit tonë vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bimët bujtëse e kanë origjinën nga një zonë e cila është shpallur e pastër nga dëmtuesi i specifikuar nga organizata kombëtare për mbrojtjen e bimëve përkatëse, në përputhje me ISPM nr. 4 dhe mbi bazën e inspektimeve zyrtare të kryera përmes marrjes së mostrave dhe testeve, duke përdorur një

test të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e autoritetit për inspektime statistikisht të besueshme dhe të bazuar në risk për *Xylella fastidiosa*, skema e inspektimit dhe marrjes së mostrave duhet të jenë në gjendje të identifikojnë, me një nivel të mjaftueshëm besueshmërie, një nivel të ulët të pranisë së dëmtuesit të specifikuar;

b) autoriteti kompetent i mbrojtjes së bimëve të vendit tjetër, përveç atyre të BE-së, i ka komunikuar me shkrim Komisionit Evropian emrin e zonës së pastër dhe kjo deklaratë është publikuar në faqen zyrtare të BE-së “Deklarata nga vendet joanëtare të BE-së në lidhje me statusin e *Xylella fastidiosa*”;

Në rast se një deklaratë e tillë nuk është e publikuar si më lart, autoriteti kompetent i vendit tjetër njofton me shkrim autoritetin kompetent në Ministri të vendit tonë.

Për vendet e BE-së statusi në lidhje me *Xylella fastidiosa* do të verifikohet në faqen zyrtare të BE-së për *Xylella fastidiosa*;

c) bimët bujtëse shoqërohen me një certifikatë fitosanitare që deklaron se ato kanë kaluar të gjithë jetën e tyre në zonën e përmendur në shkronjën “a” të këtij neni, me referencë specifike për emrin e asaj zone;

ç) bimët bujtëse janë rritur në një vend që i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent dhe sipas rastit për nivelin e riskut, me marrjen e mostrave dhe testimin me një nga testet të renditur në aneksin III, të kryera në kohën e duhur në ato bimë për praninë e dëmtuesit të specifikuar;

d) Bimët për mbjellje, përveç farave, të *Coffea* L., *Lavandula angustifolia* Mill., *Lavandula dentata* L., *Lavandula x intermedia* Emeric ex Loisel., *Lavandula latifolia* Medik., *Lavandula stoechas* L., *Nerium oleander* L., *Olea europaea* L., *Polygala myrtifolia* L., *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Ėëbb dhe *Salvia rosmarinus* Spenn., janë kultivuar në një vend i cili i nënshtrohet inspektimit vjetor nga autoriteti kompetent, me marrje mostrash dhe teste të listuar në aneksin III bashkëlidhur këtij udhëzimi, të kryera në kohët e përshtatshme mbi këto bimë për praninë e dëmtuesit të specifikuar, duke përdorur një skemë marrje mostrash që është në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri, një nivel pranie të bimëve të infektuara prej 1%;

e) me hyrjen në territorin e vendit, bimët bujtëse kontrollohen nga AKU-ja në përputhje me nenin 34. AKU-ja lejon hyrjen në territorin e vendit të ngarkesave që rezultojnë të pastra nga dëmtuesi i specifikuar.

Neni 31

Hyrja në territorin e vendit të bimëve bujtëse me origjinë nga një zonë prodhimi të pastër nga dëmtuesi, të një vendi të infektuar

(Ndryshuar nënndarja “ii” e shkronjës “c” të pikës 1 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. Bimët bujtëse me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se është i pranishëm dëmtuesi i specifikuar mund të hynë në territorin e vendit vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) bimët bujtëse e kanë origjinën nga një zonë prodhimi që është autorizuar si i pastër nga dëmtuesi nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve në përputhje me nenin 32;

b) autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve e vendit përkatës, përveç atyre të BE-së, i ka komunikuar me shkrim Komisionit Evropian statusin e vendit të tyre në lidhje me *Xylella fastidiosa* dhe kjo deklaratë është publikuar në faqen zyrtare të BE-së, listën e zonave të prodhimit të pastra nga dëmtuesi, duke përfshirë vendndodhjen e tyre brenda vendit. Në rast se një deklaratë e tillë nuk është e publikuar si më lart, autoriteti kompetent i vendit përkatës njofton me shkrim autoritetin kompetent në ministri të vendit tonë.

Për vendet e BE-së lista e zonave të prodhimit të pastra nga dëmtuesi në lidhje me *Xylella fastidiosa* do të verifikohet në faqen zyrtare të BE-së për *Xylella fastidiosa*.

c) bimët bujtëse shoqërohen nga një certifikatë fitosanitare që deklaron në:

i) rubrikën “*deklaratë shtesë*”, që bimët bujtëse janë prodhuar gjatë gjithë ciklit të tyre të prodhimit në një ose më shumë zona të autorizuara të pastra nga dëmtuesi nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve në përputhje me nenin 32 dhe se bimët bujtëse janë transportuar në kontejnerë ose ambalazhe të mbyllura, duke siguruar që të mos ndodhë infektimi me dëmtuesin e specifikuar përmes vektorëve të tij;

ii) emri ose kodi i vendndodhjes/vendeve të prodhimit pa dëmtues;

ç) me hyrjen në territorin e vendit, bimët bujtëse kontrollohen nga AKU-ja në përputhje me nenin

34. AKU-ja lejon hyrjen në territorin e vendit të ngarkesave që rezultojnë të pastra nga dëmtuesi i specifikuar.

2. Bimët bujtëse që kanë origjinën nga një vend tjetër ku dihet se dëmtuesi i specifikuar është i pranishëm dhe janë rritur gjithë ciklin e prodhimit në *in-vitro*, mund të hynë në territorin e vendit vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) bimët bujtëse plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

i. ato janë rritur nga farat;

ii. ato janë shumuar, në kushte sterile, nga bimë mëmë të cilat kanë kaluar gjithë jetën e tyre në një zonë të pastër nga dëmtuesi i specifikuar dhe që janë testuar dhe janë gjetur të pastra nga dëmtuesi i specifikuar;

iii. ato janë shumuar, në kushte sterile nga bimë mëmë që janë rritur në një zonë që plotëson kushtet e nenit 32 dhe që janë testuar dhe janë gjetur të pastra nga dëmtuesit e specifikuar;

b) bimët bujtëse janë rritur në një zonë prodhimi që është autorizuar si pastër nga dëmtuesi nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve në përputhje me nenin 32;

c) autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve e vendit përkatës i ka komunikuar me shkrim Komisionit Evropian ose vendit tonë, listën e vendeve të prodhimit të pastra nga dëmtues, duke përfshirë vendndodhjen e tyre brenda vendit. Për vendet e BE-së lista e zonave të prodhimit të pastra nga dëmtuesi në lidhje me *Xylella fastidiosa* do të verifikohet në faqen zyrtare të BE-së për *Xylella fastidiosa*.

ç) bimët bujtëse shoqërohen nga një certifikatë fitosanitare që deklaron si vijon në:

i. rubrikën “*deklaratë shtesë*”, që bimët bujtëse janë prodhuar në *in-vitro* për të gjithë ciklin e tyre të prodhimit në një ose më shumë vende të autorizuara si të pastër nga dëmtuesi nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve në përputhje me nenin 32 dhe se bimët bujtëse janë transportuar në kontejnerë ose ambalazhe të mbyllura, duke siguruar që nuk mund të ndodhë infeksioni me dëmtuesin e specifikuar ose ndonjë nga vektorët e tij të njohur;

ii. emri ose kodi i vendndodhjes/ve të prodhimit pa dëmtues.

Neni 32

Miratimi i zonave të prodhimit të pastra nga dëmtuesit

Një zonë prodhimi mund të miratohet si i pastër nga dëmtuesi, vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) zona e prodhimit është deklaruar nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve si një zonë me rrjet ndaj insekteve dhe e pastër nga dëmtuesi i specifikuar dhe vektorët e tij, në përputhje me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare përkatëse;

b) zona e prodhimit i është nënshtruar trajtimeve fitosanitare kundër popullatës së vektorëve në të gjitha fazat e tij, në periudha të përshtatshme të vitit për të ruajtur pastërtinë nga vektorët e dëmtuesit të specifikuar. Këto trajtime do të përfshijnë metoda efikase kimike, biologjike ose mekanike të bazuara në kushtet lokale;

c) zona e prodhimit i nënshtrohet çdo vit të paktën dy inspektimeve nga autoriteti kompetent, në kohën më të përshtatshme;

ç) sa më afër që të jetë e mundur me kohën e lëvizjes, bimët bujtëse që kanë origjinën në vendin e prodhimit i janë nënshtruar testimit molekular për praninë e dëmtuesit të specifikuar duke përdorur një test të listuar në aneksin III të këtij udhëzimi dhe duke përdorur një skemë mostrimi në gjendje të identifikojë me të paktën 90% besueshmëri, një nivel pranie të bimëve të infektuara prej 1%.

Nëse gjatë inspektimeve vjetore, autoritetet kompetente të vendit tjetër zbulojnë praninë e dëmtuesit të specifikuar ose dëmtime që komprometojnë kushtet e rrjetës kundër insekteve të vendit të prodhimit të pastra nga dëmtuesi, ata duhet të revokojnë menjëherë autorizimin dhe të pezullojnë përkohësisht lëvizjen e bimëve bujtëse. Autoritetet kompetente do të informojnë menjëherë Komisionin e BE-së ose vendin tonë.

KREU IX KONTROLLET ZYRTARE MBI LËVIZJEN E BIMËVE TË SPECIFIKUARA BRENDA DHE TË BIMËVE BUJTËSE TË VENDIT

Neni 33

Kontrollet zyrtare mbi lëvizjet e bimëve të specifikuara brenda territorit të vendit

(Ndryshuar pika 2 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja kryen kontrolle zyrtare sistematike mbi bimët e specifikuara që zhvendosen nga një zonë e shënuar ose nga një zonë e infektuar në një zonë sigurie.

2. Kontrolle të tilla do të kryhen, të paktën, në vendndodhje të tilla si rrugët, aeroportet dhe portet, ku bimët e specifikuara zhvendosen nga zonat e infektuara në zonat e sigurisë ose në pjesë të tjera të territorit të vendit.

3. Këto kontrolle përfshijnë një kontroll dokumentar dhe një kontroll identiteti të bimëve të specifikuara.

4. Këto kontrolle kryhen pavarësisht nga origjina e deklaruar e bimëve të specifikuara, pronësia ose personi ose subjekti përgjegjës për to.

5. Kur këto kontrolle tregojnë se kushtet e përcaktuara në nenet 20 deri në 24 nuk plotësohen, AKVMB-ja, do të shkatërrojë menjëherë bimët që nuk është në përputhje në vend ose në një vendndodhje afër. Ky veprim do të kryhet duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur përhapjen e dëmtuesit të specifikuar dhe çdo vektori të mbartur nga ajo bimë, gjatë dhe pas heqjes.

Neni 34

Kontrollet zyrtare në pikat e kalimit kufitar

1. Të gjitha ngarkesat e bimëve bujtëse, të importuara në vend nga një vend tjetër, do të kontrollohen zyrtarisht sipas nenit 14, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

2. Në rastin e bimëve bujtëse me origjinë nga zonat ku dihet se dëmtuesi i specifikuar është hasur, AKU-ja do të kryejë një inspektim, i cili konsiston në marrjen e mostrave dhe testimin e lotit të bimëve të specifikuara për të konfirmuar pastërtinë nga dëmtuesi i specifikuar duke përdorur një skemë mostrimi në gjendje të identifikojë me të paktën 80% besueshmëri, një nivel të bimëve të infektuara

prej 1%, sipas urdhrorit mbi procedurat e marrjes së mostrave. Në këtë rast ngarkesa do të qëndrojë në vendin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, e bllokuar deri në daljen e rezultatit të analizave.

3. Pika 2 e këtij neni, nuk zbatohet për bimët bujtëse të cilat janë rritur për të gjithë ciklin e prodhimit në *in-vitro* dhe janë transportuar në kontejnerë transparentë në kushte sterile.

KREU X AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT

Neni 35 Fushata ndërgjegjëse

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKVMB-ja, AKU-ja dhe AREB-ja do të vënë në dispozicion informacionin për publikun e gjerë, udhëtarët, operatorët profesionistë dhe operatorët e transportit ndërkombëtar, në lidhje me kërcënimin e dëmtuesit të specifikuar për territorin e vendit. Informacioni bëhet i disponueshëm publikisht, në formën e fushatave ndërgjegjëse të llojeve të ndryshme.

2. Brenda zonave të shënuara, të rritet ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me kërcënimin e dëmtuesit të specifikuar dhe masat e miratuara për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen e tij brenda vendit. AKVMB-ja, AKU-ja dhe AREB-ja të sigurojnë që publiku i gjerë, udhëtarët dhe operatorët përkatës të jenë në dijeni të përcaktimit të zonës së shënuar, zonës së infektuar dhe zonës sigurisë.

AKVMB-ja të informojë, gjithashtu, operatorët përkatës për masat që duhen marrë kundër vektorit siç parashikohet në nenet 9 dhe 15.

Neni 36 Raportimi mbi masat (Shfuqizuar pika 2, 3 dhe 4 me udhëzimin nr. 22, datë 14.7.2025)

1. AKVMB-ja dhe AKU-ja raportojnë pranë autoritetit kompetent të mbrojtjes së bimëve në ministri, brenda datës 25 shkurt të çdo viti, të gjitha masat e marra sipas rastit dhe rezultatet gjatë vitit paraardhës në përputhje me këtë udhëzim, sipas përgjegjësisë përkatëse. ISUV-ja raporton mbi mostrat e analizuar dhe rezultatin e tyre.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

Neni 37 Dispozitat përfundimtare

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare.

2. Urdhri nr. 409, datë 21.8.2014 “Për ndalimin e importit të fidanëve të ullirit”, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më datë 1.9.2023. Përgjashtimisht, pika 4, e nenit 2, shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 6, shkronja “a” e nenit 29 dhe shkronja “a” të nenit 30, hyjnë në fuqi më datë 1.1.2024.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANEKS I

LISTA E BIMËVE QË DIHET SE JANË TË NDJESHME NDAJ NJË OSE MË SHUMË
NËNSPECIEVE TË DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR (“BIMËT BUJTËSE”)

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 204, datë 28.12.2023; nr. 22, datë 14.7.2025)

Acacia Mill.
Acer L.
Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.
Albizia julibrissin Durazz.
Alnus rhombifolia Nutt.
Amaranthus retroflexus L.
Ambrosia L.
Ampelopsis arborea (L.) Koehne
Ampelopsis brevipedunculata (Maxim.) Trautv.
Ampelopsis cordata Michx.
Anthyllis barba-jovis L.
Anthyllis hermanniae L.
Arbutus unedo L.
Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.
Artemisia L.
Asparagus acutifolius L.
Athyrium filix-femina (L.) Roth
Baccharis L.
Berberis thunbergii DC.
Brassica L.
Calicotome spinosa (L.) Link
Calicotome villosa (Poir.) Link
Callicarpa americana L.
Callistemon citrinus (Curtis) Skeels
Calluna vulgaris (L.) Hull
Calocephalus broëni (Cass.) F.Muell.
Carya Nutt.
Castanea sativa Mill.
Catharanthus roseus (L.) G.Don
Celtis occidentalis L.
Cercis canadensis L.
Cercis occidentalis Torr.
Cercis siliquastrum L.
Chamaecrista fasciculata (Michx.) Greene
Chenopodium album L.
Chionanthus L.

× Chitalpa tashkentensis T. S. Elias & Eišura
Cistus L.
Citrus L.
Clematis cirrhosa L.
Clematis vitalba L.
Clinopodium nepeta (L.) Kuntze
Coelorachis cylindrica (Michx.) Nash
Coffea L.
Conium maculatum L.
Convolvulus cneorum L.
Coprosma repens A.Rich.
Cornus sanguinea L.
Coronilla L.
Cortaderia selloana (Schult. & Schult.f.) Asch. & Graebn.
Cyperus eragrostis Lam.
Cytisus Desf.
Digitaria Haller
Dimorphotheca ecklonis (DC.) Norl.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Diospyros kaki L.f.
Diplocyclos palmatus (L.) C.Jeffrey
Dittrichia viscosa (L.) Greuter
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Echium plantagineum L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × submacrophylla Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Eremophila maculata (Ker Gaëler) F. von Müller.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Eriocephalus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Erysimum L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fagus crenata Blume
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Fatsia japonica (Thunb.) Decne. & Planch.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.

Grevillea juniperina Br.
Grevillea rosmarinifolia A. Cunn.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helichrysum Mill.
Heliotropium europaeum L.
Hemerocallis L.
Hevea brasiliensis (Eülld. ex A.Juss.) Müll.Arg.
Hibiscus L.
Humulus scandens (Lour.) Merr.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Ilex vomitoria Sol. ex Aiton
Iva annua L.
Jacaranda mimosifolia D. Don
Jacobaea maritima (L.) Pelser & Meijden
Juglans L.
Juniperus asbei J. Buchholz
Koelreuteria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Ligustrum lucidum E.T.Aiton.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lonicera perichlymenum L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Eülld.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia × soulangeana Soul.-Bod.
Mallotus paniculatus (Lam.) Müll.Arg.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Mentha suaveolens Ehrh.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Mimosa L.
Modiola caroliniana (L.) G. Don
Morus L.
Myoporum insulare R.Br.
Myoporum laetum G. Forst.
Myrtus communis L.
Nandina domestica Murray
Neptunia lutea (Leavenë.) Benth.
Nerium oleander L.

Olea L.
Parthenocissus quinquefolia (L.) Planch.
Paspalum dilatatum Poir.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Persea americana Mill.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phillyrea latifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Phoenix reclinata Jacquin
Phoenix roebelenii O'Brien
Pinus taeda L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala grandiflora Æight
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Pyracantha coccinea M. Roem.
Pyrus L.
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Eooton & Standl.
Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus alaternus L.
Rhamnus L.
Rhus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.
Ruta chalepensis L.
Ruta graveolens L.
Salvia apiana Jeps.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.) Romo
Sapindus saponaria L.
Sassafras L. ex Nees
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Senecio inaequidens DC.

Setaria magna Griseb.
Solidago fistulosa Mill.
Solidago virgaurea L.
Sorghum halepense (L.) Pers.
Spartium L.
Steëartia pseudocamellia Maxim.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Symphytotrichum divaricatum (Nutt.) G.L.Nesom
Syringa vulgaris L.
Teucrium capitatum L.
Thymus vulgaris L.
Trifolium repens L.
Ulex L.
Ulmus L.
Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Vitis L.
Ëestringia fruticosa (Ëilld.) Druce
Ëestringia glabra R.Br.
Xanthium strumarium L.

ANEKS II

LISTA E BIMËVE QË DIHET SE JANË TË NDJESHME NDAJ NËNSPECIEVE SPECIFIKE TË DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR (BIMËT TË SPECIFIKUARA)

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 204, datë 28.12.2023; nr. 22, datë 14.7.2025)

Bimët e specifikuara të ndjeshme ndaj *Xylella fastidiosa* nënspecie *fastidiosa*

Acer L.
Ambrosia artemisiifolia L.
Calicotome spinosa (L.) Link
Cercis occidentalis Torr.
Cistus monspeliensis L.
Citrus limon (L.) Osbeck
Citrus paradisi Macfad.
Citrus reticulata Blanco
Citrus sinensis (L.) Osbeck
Coffea L.
Elaeagnus angustifolia L.
Erysimum L.
Ficus carica L.
Fraxinus angustifolia Vahl
Genista lucida L.
Juglans regia L.

Liquidambar styraciflua L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Magnolia grandiflora L.
Medicago sativa L.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Morus L.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Pelargonium graveolens L'Hér.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Quercus ilex L.
Rhamnus alaternus L.
Rubus ideaus L.
Rubus rigidus Sm.
Rubus ursinus Cham. & Schldl.
Ruta chalepensis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Spartium junceum L.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Teucrium capitatum L.
Ulex europaeus L.
Ulmus americana L.
Vaccinium corymbosum L.
Vinca L.
Vitis L.

Bimët e specifikuara të ndjeshme ndaj nënspecies *Xylella fastidiosa* multiplex

Acacia Mill.
Acer granatense Boiss.
Acer griseum (Franch.) Pax
Acer pseudoplatanus L.
Acer rubrum L.
Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.
Alnus rhombifolia Nutt.
Ambrosia L.
Ampelopsis cordata Michx.
Anthyllis barba-jovis L.
Anthyllis hermanniae L.
Arbutus unedo L.
Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.
Artemisia L.
Asparagus acutifolius L.

Athyrium filix-femina (L.) Roth
Baccharis halimifolia L.
Berberis thunbergii DC.
Calicotome spinosa (L.) Link
Calicotome villosa (Poir.) Link
Callistemon citrinus (Curtis) Skeels
Calluna vulgaris (L.) Hull
Calocephalus broëni (Cass.) F.Muell
Carya Nutt.
Castanea sativa Mill.
Celtis occidentalis L.
Cercis canadensis L.
Cercis occidentalis Torr.
Cercis siliquastrum L.
Chenopodium album L.
Chionanthus L.
Cistus L.
Clematis cirrhosa L.
Clematis vitalba L.
Clinopodium nepeta (L.) Kuntze
Convolvulus cneorum L.
Coprosma repens A.Rich.
Cornus sanguinea L.
Coronilla L.
Cytisus Desf.
Dimorphotheca ecklonis (DC.) Norl.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Dittrichia viscosa (L.) Greuter
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Echium plantagineum L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × *submacrophylla* Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Erioccephalus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.

Grevillea juniperina Br.
Grevillea rosmarinifolia A. Cunn.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helichrysum Mill.
Hibiscus syriacus L.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Iva annua L.
Jacobaea maritima (L.) Pelser & Meijden
Koelreuteria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lonicera periclymenum L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Eïlld.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia × soulangeana Soul.-Bod.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Mentha suaveolens Ehrh.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Myoporum laetum G.Forst.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Olea L.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Polygala grandiflora Eïght
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Eooton & Standl.

Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus alaternus L.
Rhamnus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.
Ruta graveolens L.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.) Romo
Sapindus saponaria L.
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Senecio inaequidens DC.
Solidago virgaurea L.
Spartium L.
Strelitzia reginae Aiton
Syringa vulgaris L.
Ulex L.
Ulmus L.
Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Æstringia fruticosa (Eildd.) Druce
Xanthium strumarium L.

Bimët të specifikuara të ndjeshme ndaj nënspecieve *Xylella fastidiosa* pauca

Acacia Mill.
Amaranthus retroflexus L.
Asparagus acutifolius L.
Catharanthus roseus (L.) G.Don
Chenopodium album L.
Cistus albidus L.
Cistus creticus L.
Citrus L.
Coffea L.
Dimorphanthea fruticosa (L.) Norl.
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Elaeagnus angustifolia L.
Eremophila maculata (Ker Gaëler) F. von Müller.
Erigeron L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Genista hirsuta Vahl.

Grevillea juniperina Br.
Hebe Comm. ex Juss.
Heliotropium europaeum L.
Hibiscus L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Myoporum insulare R.Br.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Olea europaea nēnsp. *europaea* L.
Olea europaea nēnsp. *sylvestris* (Mill.) Rouy
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Phillyrea latifolia L.
Pistacia vera L.
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Rhamnus alaternus L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Spartium junceum L.
Thymus vulgaris L.
Ulex parviflorus Pourr.
Vinca minor L.
Westringia fruticosa (Eilld.) Druce
Westringia glabra R.Br.

Aneksi III

Testet për identifikimin e *Xylella fastidiosa* dhe nëngrupet

- A. Testet për shqyrtimin dhe identifikimin e pranisë së *Xylella fastidiosa*
1. PCR në kohë reale bazuar në Harper *et al.*, 2010 (dhe erratum 2013) ⁽¹⁾;
 2. Amplifikimi izotermik i ndërmjetësuar nga Loop-Mediaated (LAMP) i bazuar në primers e zhvilluar nga Harper *et al.* 2010 (dhe erratum 2013) ⁽²⁾;
 3. PCR në kohë reale bazuar në Ouyang *et al.*, 2013 ⁽³⁾;
 4. PCR konvencionale e bazuar në Minsavage *et al.* 1994 ⁽⁴⁾;
- B. Testet molekulare për identifikimin e nënspecieve të *Xylella fastidiosa*
1. Shtypja e Sekuencës me Multi Locus (MLST) bazuar në Yuan *et al.*, 2010 që përcakton të gjitha nënspeciet ⁽⁵⁾;
 2. PCR bazuar në Hernandez-Martinez *et al.*, 2006 që përcakton nëngrupin *fastidiosa*, *multiplex* dhe *sandyi* ⁽⁶⁾;
 3. PCR bazuar në Pooler&Hartung 1995 që përcakton nëngrupin *pauca* ⁽⁷⁾.

¹ DOI: 10.1094/PHYTO-06-10-0168.

² DOI: 10.1094/PHYTO-06-10-0168.

³ DOI: 10.1371/ditar.pone.0081647.

⁴ DOI:10.1094/Phyto-84-456.

⁵ DOI: 10.1094/PHYTO-100-6-0601.

⁶ DOI: 10.1094/PD-90-1382.

⁷ DOI: 10.1007/BF00294703.

4. Real time PCR, bazuar në Dupas *et al.*, 2019, për përcaktimin e të gjitha nënspecieve. (*)⁸.
5. Real time PCR, bazuar në Hodgetts *et al.*, 2021, për përcaktimin e të gjitha nënspecieve. (**) ⁹

⁸ DOI: 10.3389/fpls.2019.01732

⁹ DOI: 10.1111/jam.14903

Aneksi IV

Modelet për raportimin e rezultateve të vrojtimeve të kryera në përputhje me nenet 11 dhe 16 në zonat e shënuara

PJESA A

Model për raportin e rezultateve të vrojtimeve vjetore të bazuara statistikisht

1. Vëndodhja gjeografike e ZSH		2. Madhësia fillestare e ZSH (ha)		3. Madhësia e përditësuar e ZSH (ha)		4. Qasja (C/F)		5. Zona (p.sh. ZS/12)		6. Vendet e vërtetimit		7. Koha		A. Përkufizimi i vërtetimit (parametrat e hyrjes për RiBESS+)						B. Përpjekje për marrjen e mostrave					C. Rezultatet e vërtetimit																				
														8. Popullata e synuar		9. Njësitë epidemiologjike		10. Metoda e zbulimit		11. Efektiviteti i mostrimit		12. Ndjeshmëria e metodës		13. Faktorët e riskut (aktivitetet, vëndndodhjet dhe zonat)		14. Nr. i njësisë epidemiologjike të inspektuara		15. Nr. i kontroleve		16. Nr. i mostrave		17. Nr. i testeve		18. Nr. i masave të tjera		19. Rezultatet		20. Numri i njoftimit të shpërthimeve të njoftuara, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin në fuqi		21. niveli i arrituri i besueshmëris		22. Prevalenca e përcaktimit		23. komentet	
														Llojet e bujtëse		Përshkrimi		Kontrollet vizuale		Testimi		Metoda të tjera																							
														Sipërfaqja (ha ose njësi tjetër më e rëndësishme))		Njësitë e inspektimit								Faktorët i riskut		Nivelet e riskut		Numri i vëndndodhjeve		Risqet relative		Përqindja e popullatës bujtëse													

Udhëzime se si të plotësoni modelin

Shpjegoni supozimet për hartimin e vërtetimit. Përmblihdhni dhe arsyetoni:

- Popullata e synuar, njësia epidemiologjike dhe njësitë e inspektimit;
- Metoda e zbulimit dhe ndjeshmëria e metodës;
- Faktorët e riskut që tregojnë nivelet e riskut dhe rreziqet përkatëse relative dhe proporcionet e popullatës së bimëve bujtëse.

Për kolonën 1: Shënoni emrin e zonës gjeografike, numrin e shpërthimit ose çdo informacion që lejon identifikimin e zonës së shënuar (ZSH) në fjalë dhe datën kur është shpallur.

Për kolonat 2 dhe 3: Shënoni madhësinë e ZSH-së përpara fillimit të vërtetimit dhe çdo përditësimi përkatës.

Për kolonën 4: Shënoni qasjen: Çrrënjosjen (Ç), Frenimin (F). Ju lutemi, përfshini sa më shumë rreshta që të jetë e nevojshme, në varësi të numrit të ZSH-së dhe qasjeve të cilave u nënshtrohen këto zona.

Për kolonën 5: Shënoni zonën e ZSH-së ku është kryer vërtetimi, duke përfshirë sa më shumë rreshta që është e nevojshme: Zona e infektuar (ZI) ose zona e sigurisë (ZS), duke përdorur rreshta të veçantë. Kur është e zbatueshme, Shënoni zonën e ZI-së ku është kryer studimi (p.sh. 5 km e fundit ngjitur me ZS, rreth fidanishteve etj.) në rreshta të ndryshëm.

Për kolonën 6: Shënoni vendet e vërtetimit, duke përdorur më shumë se një rresht nëse është e nevojshme. Ju lutemi, gjithmonë raportoni vërtetimet e kryera në fidanishte në një rresht tjetër. Kur përdorni opsionin “tjera”, ju lutemi, specifikoni se çfarë është:

1. Mjedisë të hapura (zona e prodhimit): 1.1 arë (arë, kullotë); 1.2. pemëtore/vresht; 1.3. fidanishte; 1.4. pyll;
2. Mjedisë të hapura (të tjera): 2.1. kopshte private; 2.2. vende publike; 2.3. zonat e ruajtjes; 2.4. bimë të egra në zona të ndryshme nga zonat e ruajtjes; 2.5. tjera, me specifikimin e rastit të caktuar (p.sh. qendër e kopshti etj.);
3. Mjedisë të mbyllura: 3.1. serra; 3.2. vend privat, përveç serrës; 3.3. vend publik, përveç serrës; 3.4. tjetër, me specifikimin e rastit të caktuar (p.sh. qendër e kopshti).

Për kolonën 7: Shënoni muajt e vitit kur janë kryer vërtetimet.

Për kolonën 8: Shënoni popullatën e zgjedhur të synuar, duke ofruar në përputhje me rrethanat listën e specieve bujtëse dhe zonën e mbuluar. Popullata e synuar përkufizohet si tërësia e njësive të inspektimit. Madhësia e tij zakonisht përkufizohet për sipërfaqet bujqësore si hektarë, por mund të jenë parcela, ara, serra etj. Ju lutemi, arsyetoni zgjedhjen e bërë në supozimet themelore në kolonën 23 (“Komente”). Shënoni njësitë e inspektimit të vërtetuara. “Njësia e inspektimit” nënkupton bimët, pjesët e bimëve, mallrat, materialet, vektorët e dëmtuesve që janë kontrolluar për identifikimin dhe zbulimin e dëmtuesve.

Për kolonën 9: Shënoni njësitë epidemiologjike të vërtetuara, duke treguar përshkrimin e saj dhe njësinë e matjes. “Njësi epidemiologjike” nënkupton një zonë homogjene ku ndërveprimet midis dëmtuesit, bimëve bujtëse dhe faktorëve dhe kushteve abiotike dhe biotike do të rezultojnë në të njëjtën epidemiologji, nëse dëmtuesi është i pranishëm. Njësitë epidemiologjike janë një nënndarje e popullatës së synuar, të cilat janë homogjene në aspektin epidemiologjik dhe që përfshijnë të paktën një bimë bujtëse. Në disa raste e gjithë popullata bujtëse në një rajon/zonë/vend mund të përkufizohet si njësi epidemiologjike. Ato mund të jenë zona urbane, pyje, kopshte me trëndafila ose ferma, ose hektarë. Zgjedhja do të justifikohet në supozimet themelore.

Për kolonën 10: Shënoni metodat e përdorura gjatë vërtetimit duke përfshirë numrin e aktiviteteve në secilin rast. Shënoni me N/A kur informacioni i kolonës së caktuar nuk është i disponueshëm.

Për kolonën 11: Shënoni një vlerësim të efektivitetit të mostrimit. Efektiviteti i mostrimit nënkupton mundësinë e përzgjedhjes së pjesëve të bimëve të infektuara nga një bimë e infektuar. Për vektorët, është efektiviteti i metodës për të kapur një vektor pozitiv kur ai është i pranishëm në zonën e vërtetimit. Për tokën, është efektiviteti i zgjedhjes së një mostër dheu që përmban dëmtuesin kur dëmtuesi është i pranishëm në zonën e studimit.

Për kolonën 12: “Ndjeshmëria e metodës” nënkupton probabilitetin e një metode për të zbuluar saktë praninë e dëmtuesve. Ndjeshmëria e metodës përkufizohet si probabiliteti që një bujtës vërtet pozitiv të dalë pozitiv. Është shumëzimi i efektivitetit të mostrimit (d.m.th. probabiliteti i përzgjedhjes së pjesëve të bimëve të infektuara nga një bimë e infektuar) me ndjeshmërinë diagnostike (e karakterizuar nga inspektimi vizual dhe/ose testi laboratorik i përdorur në procesin e identifikimit).

Për kolonën 13: Jepni faktorët e riskut në rreshta të ndryshëm, duke përdorur sa më shumë rreshta që është e nevojshme. Për secilin faktor risku Shënoni nivelin e riskut dhe rrezikun përkatës relativ dhe përqindjen e popullatës bujtëse.

Për kolonën B: Shënoni detajet e vërtetimit. Shënoni me N/A kur informacioni i kolonës së caktuar nuk është i zbatueshëm. Informacioni që duhet të jepet në këto kolona lidhet me informacionin e përfshirë në kolonën 10 “Metodat e zbulimit”.

Për kolonën 19: Shënoni numrin e mostrave të gjetura pozitive, negative ose të papërcaktuara. “Të papërcaktuara” janë ato mostra të analizuara për të cilat nuk është marrë asnjë rezultat për shkak të faktorëve të ndryshëm (p.sh. nën nivelin e zbulimit, mostra e papërpunuar – e paidentifikuar, e vjetër etj.).

Për kolonën 20: Shënoni njoftimet e shpërthimit të vitit kur u zhvillua vërtetimi. Numri i njoftimit të shpërthimit nuk ka nevojë të përfshihet kur autoriteti kompetent ka vendosur që gjetja është sipas nenit 15 të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”. Në këtë rast, ju lutemi, shënoni arsyen e mosdhënies së këtij informacioni në kolonën 21 (“Komente”).

Për kolonën 21: Shënoni ndjeshmërinë e studimit, siç përcaktohet në ISPM 31. Kjo vlerë e nivelit të arritur të besueshmërisë së pastërtisë së dëmtuesve llogaritet bazuar në inspektimet (dhe/ose mostrat) të kryera duke pasur parasysh ndjeshmërinë e metodës dhe prevalencën e përcaktimit.

Për kolonën 22: Shënoni prevalencën e përcaktimit bazuar në një vlerësim para vërtetimit të prevalencës aktuale të mundshme të dëmtuesit në fushë. Prevalenca e përcaktimit është vendosur si një qëllim i vërtetimit dhe korrespondon me kompromisin që drejtuesit e riskut po bëjnë midis riskut për të pasur dëmtuesin dhe burimeve të disponueshme për vërtetim.

.

PJESA B

Model për raportin e rezultateve të vrojtimeve të kryera për vektorët e Xylella fastidiosa

Emri	1. Përkthim e të ZSH		2. Qasje	3. Zona	4 Llojet vektoriale	5. Kontrollat vizuale		6. Lloji i kurtheve (ose metoda të tjera të kapjes së vektorit (p.sh., rrjeta për flutur etj.))	7. Nr. i kurtheve (ose metodat tjera kapje)	8. Frekuenca e kontrollit të kurtheve (ose metodë tjetër, nëse është e aplikueshme)	9. Koha e kontrollit të kurtheve (ose metodë tjetër, nëse është e aplikueshme)	10. Numri i mostrave vektoriale të mbledhura	11. Numri i vektorëve të kapur	12. Numri i vektorëve të analizuar	13. Numri i mostrave vektoriale të analizuar	14. Numri i mostrave të vektorit pozitiv	15. Numri i mostrave të vektorit negativ	16. Numri i mostrave vektoriale të papërcaktuara	17. Komentet
	Data e shpalljes					Koha	Numri												

Udhëzime se si të plotësoni modelin

Për kolonën 1: Shënoni emrin e zonës, numrin e shpërthimit ose çdo informacion që lejon identifikimin e Zonës së Shënuar (ZSH) dhe datën e shpalljes.

Për kolonën 2: Shënoni: Çrrënjosjen (E), Frenimin (F). Ju lutemi, përfshini sa më shumë rreshta që të jetë e nevojshme, në varësi të numrit të ZSH dhe qasjeve të cilave u nënshtrohen këto zona.

Për kolonën 3: Shënoni zonën e ZSH ku është kryer vërtetimi: Zona e infektuar (ZI) ose zona e sigurisë (ZS), duke përdorur rreshta të veçantë. Kur është e mundur, Shënoni zonën e ZI ku është kryer vërtetimi (p.sh. 5 km e fundit, rreth fidanishteve etj.).

Për kolonën 4: Shënoni listën e llojeve vektoriale të dëmtuesit të treguar në kolonën e parë, duke përdorur rreshta të ndryshëm për vektor.

Për kolonën 5: Shënoni vetëm nëse është e aplikueshme.

Për kolonën 6: Shënoni llojin e metodës së kapjes së vektorit. Kur përdoren më shumë se një metodë për të njëjtin vektor, jepni të dhënat në rreshta të veçantë.

Për kolonën 7: Shënoni numrin e kurtheve ose metodën tjetër të kapjes, duke përdorur një rresht të veçantë për metodë.

Për kolonën 8: Shënoni kur janë kontrolluar kurthet ose metodat e kapjes (p.sh. një herë në javë, një herë në muaj, katër herë në vit etj.).

Për kolonën 9: Shënoni muajt e vitit kur kontrollohen kurthet.

Për kolonën 10: Shënoni numrin e mostrave të mbledhura (një mostër mund të përmbajë disa vektore).

Për kolonën 11: Shënoni numrin total të vektorëve të kapur. Ju lutemi, përfshini vetëm numrin e vektorit të interesuar, pa kapje anësore.

Për kolonën 13: Shënoni numrin e mostrave vektoriale të analizuara për dëmtuesin, i zbatueshëm kur një mostër përbëhet nga më shumë se një vektor.

Për kolonën 16: Numri i mostrave të papërcaktuara, përkatësisht mostrat e analizuara, por ku për shkak të faktorëve të ndryshëm nuk është marrë asnjë rezultat (p.sh. nën nivelin e zbulimit etj.).”